

**URDHËR**  
**Nr.498, datë 7.10.2011**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË TË DOKTORATËS, NË  
UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI” TË SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Hapjen në universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të Doktoratës në “Gjuhë shqipe”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr) në “Gjuhë shqipe”.

2. Programi i studimeve të ciklit të tretë, të Doktoratës, zgjat të paktën 3 vite akademike dhe përfshin 60 kredite për studime të organizuara teorike.

3. Programi i studimeve të fillojë në vitin akademik 2011-2012.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, i Shkodrës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**